

Njoftim për Media

Fjala e Drejtorit të Përgjithshëm të INSTAT Z. Gjergji Filipi për Konferencën mbi Statistikat Rajonale dhe Buxhetin e Familjes 2014

Tiranë, më 17 Shtator 2015:

Përshëndetje,

I nderuar z. Philipp Keller, zv.ambasador i Ambasadës Zvicerane në Shqipëri, të nderuar pjesëmarrës ju uroj mirëseardhjen në “Konferencën mbi Statistikat Rajonale dhe Buxhetin e Familjes 2014”.

Gjej rastin këtu për të falënderuar të gjithë pjesëmarrësit dhe veçanërisht ambasadën zvicerane për kontributin e vazhdueshëm që i ka dhënë INSTAT për pasurimin e produkteve statistikore si dhe për rritjen e cilësisë së tyre.

Në këtë konferencë sot do të bëjmë publike dy produkte statistikore të reja të cilat sot më shumë se kurrë marrin një rëndësi të veçantë për vendin tonë. Ka një nevojë në rritje dhe ndërgjegjësim nga ana e përdoruesve si dhe politikë bërësve për rëndësinë dhe nevojën për më shumë të dhëna në nivel më të disagreguar se niveli kombëtar. INSTAT për tju përgjigjur kësaj nevoje në rritje si dhe për të plotësuar këtë hendek të krijuar vjen para përdoruesve më këtë produkt të ri, Vjetari statistikor Rajonal 2015.

Së pari INSTAT për herë të parë ka krijuar një vjetar statistikor rajonal, ky të gjithë treguesit statistikor të disponueshëm deri tani janë vendosur në këtë kontekst duke dhënë një pamje sa më të plotë të statistikave rajonale. Ky botim është konceptuar duke ndjekur linjën e një botimi të ngjashëm të statistikave europiane, si nga konceptimi i kapitujve të cilët janë të veçantë për çdo fushë statistikore si dhe në përmbajtjen brenda kapitujve të cilët shoqërohen me një përshkrim për çdo fushë, gjetjet kryesore si dhe burimet kryesore të të dhënave të janë shfrytëzuar për llogaritjet e bëra. Botimi i referohen kryesisht periudhës kohore 2010-2014 dhe është pasuruar me tabela, grafikë dhe harta të cilat shoqërojnë analizën e bërë për çdo fushën statistikore. Ky botim do të jetë pjesë e planit kalendarik të periudhave në vazhdim, që do të thotë se përdoruesi do të ketë në duart e tij këtë produkt statistikor i cili do të pasurohet çdo vit me tregues të rinj me qëllim harmonizimin e tij me vendet e BE.

Së dyti, sot INSTAT do të publikojë të dhënat e Anketës së Buxhetit të Familjes 2014. Ky produkt do të japë një pasqyrim të buxhetit të familjeve shqiptare për të kuptuar nivelin dhe strukturën e shpenzimeve

Për publikim 17/09/2015

për konsum. Gjithashtu, të dhënat që mbliidhen nga kjo anketë, janë të rëndësishme për përditësimin e shportës së konsumit për llogaritjen e Indeksit të Çmimeve të Konsumit.

Disa nga gjetjet më pikante të kësaj ankete janë:

- *Shpenzimet mesatare mujore për konsum të NjEF në vitin 2014 llogariten të jenë 69.442 Lekë.*
- *Në vitin 2014, një person shpenzon mesatarisht rreth 18 mijë Lekë në muaj nga të cilat: 8 mijë Lekë për konsum ushqimor dhe 10 mijë Lekë për konsum jo-ushqimor.*
- *Shpenzimi mesatar për frymë për konsum ushqimor (ushqime dhe pije jo-alkoolike) ndaj shpenzimeve gjithsej në vitin 2014, ulet nga 50 përqind në vitin 2009, në rreth 44 përqind në vitin 2014.*
- *NjEF në Shqipëri shpenzojnë 10,2 përqind të buxhetit total për qira të paguar, ujë, energji elektrike, lëndë djegëse dhe riparime të vogla të banesës.*
- *Ndër shpenzimet për arsim të cilat zënë 4,2 përqind të buxhetit gjithsej, peshën më të madhe e zënë pagesat në lidhje me kategorinë "Master (niveli i parë dhe i dytë)", me 58,8 përqind.*
- *Disa gjetje në nivel rajonal mund të veçojmë: Dibra është qarku i cili pjesën më të madhe të buxhetit e shpenzon për ushqime dhe pije jo-alkoolike me 49,2 përqind pasuar nga Vlora me 49,1 përqind. Në shpenzimet për veshje qarku i Tiranës ka përqindjen më të lartë, 6,6 përqind. Berati është qarku me shpenzimet më të larta për shëndet me 6,4 përqind.*

Siç shihet këto dy produkte të reja janë një dëshmi e punës së vazhdueshme të INSTAT për përmirësimin e treguesve aktualë si dhe për krijimin e statistikave të reja, të cilat synojnë të japin një panoramë edhe më të plotë të gjendjes social-ekonomike të Shqipërisë.

Statistikat janë një instrument mjaft i rëndësishëm për të kuptuar mirë gjendjen e shoqërisë sonë dhe INSTAT tashmë ka vendosur online në dispozicion të gjithë të dhënat që disponon në format të përpunueshëm për t'i lejuar çdokujt të kryejë analiza të mëtejshme. Por, nga ana tjetër, ne jemi gjithashtu të interesuar dhe të gatshëm të rrisim bashkëpunimin me këdo për të kryer analiza apo studime të tjera për të pasuruar më tej panoramën e gjendjes sociale e ekonomike të shoqërisë shqiptare.